



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 196, datë 13.12.2024

PËR

**AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “DIZAJN” ME PROFILE, “DIZAJN GRAFIK” DHE “DIZAJN
INTERIER”, TË UNIVERSITETIT TË NEW YORK-UT NË TIRANË**

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Dizajn” me profile, “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në “Dizajn” me profile, “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier”
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 235, datë 19.07.2021
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti i New York-ut në Tiranë
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite / 6 semestra
- g) Kredite (ECTS): 180 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht
- j) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti i New York-ut në Tiranë
- k) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimit të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor”*” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësi si më poshtë:
 1. Mungesa e një laboratorit dhe hapësirave të dedikuara për printime dhe prodhime materiale, në funksion të këtij programi studimi.
 2. Mungesa në bibliotekën e institucionit e literaturës specifike dhe të përshtatur, në funksion të profileve të këtij programi studimi.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Bachelor në **“Dizajn” me profile, “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier”**, të Universitetit të New York-ut në Tiranë.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **4 (katër) vite**.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **12.12.2028**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

ALEXANDER KOHLER




Anëtar

AYŞEN SAVAŞ SARGIN



Anëtar

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

IRAJ HASHI



Anëtar

MAURICE OUDEJANS



Anëtar

LEA YPI


Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ



Anëtar

DARINKA PIQANI



Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shënim: Znj. Lea Ypi nuk mori pjesë në këtë mbledhje.

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 196, datë 13.12.2024, "Për akreditimin e parë të programit të studimit Bachelor në "Dizajn" me profile, "Dizajn Grafik" dhe "Dizajn Interior", të Universitetit të New York-ut në Tiranë, janë si vijon:

1. Institucioni, të marrë masa për krijimin e një laboratorit dhe hapësirave të dedikuara për printime dhe prodhime materiale, në funksion të këtij programi studimi.
2. Institucioni, të marrë masa për shtimin e përditësimit periodik të literaturës në bibliotekë, me materiale dhe libra të rinj që përmbushin nevojat specifike të profileve të këtij programi studimi, duke përfshirë risitë dhe zhvillimet më të fundit në fushën e dizajnit.
3. Institucioni, të rrisë përpjekjet për shtimin e numrit të studentëve në këtë program studimi, e si rrjedhojë garantimin e qëndrueshmërisë së tij.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti i New York-ut në Tiranë**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

